



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0332

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga :Vedat Poterqoi Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE “A-Z Group ” sh.p.k. me seli në Skenderaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi dhe zgjerimi i parqeve ne Kline” me nr. të prokurimit:634-23-1688-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Komuna e Klinës, me datën 29.06.2023, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “A-Z Group ” sh.p.k. me nr. 2023/0332 , e datës 01/06/2023, kurse vendimi i AK Kuvendi Komunal i Klinës lidhur me aktivitetin e prokurimit Rregullimi dhe zgjerim i parqeve ne Kline me numër të prokurimit 634-23-1688-5-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “A-Z Group ” sh.p.k.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 06.03.2023, Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B58 Njoftimin për Kontratë për aktivitetin të prokurimit me titull: “ Rregullimi dhe zgjerimi i parqeve ne Kline ” me nr. të prokurimit: 634-23-1688-5-2-1, Me datën 27.03.2023 është bërë hapja e tenderit dhe me datën 16.05.2023 AK ka publikuar B58-Njoftimin mbi vendimin e AK – Lista standarde ku është rekomanduar për kontratë OE “Mendi Invest ” sh.p.k.

Me datë 21.05.2023, OE ankues "A-Z Group" sh.p.k. me seli në Skenderaj ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK- Komuna e Klinës, me datë 23.05.2023 AK e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 16.05.2023

Me datën 01.06.2023 OE ankues "A-Z Group" sh.p.k. ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 322/2023, kundër B58 Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 20,000 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 09 Qershor 2023 me raportin e ekspertizës. AK Komuna e Klinës nuk është deklaruar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ankuese "A-Z Group" sh.p.k. nuk ka deklaruar se a pajtohet apo nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 09.06.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE ankues "A-Z Group" sh.p.k. me seli në Skenderaj të aprovohet, si e bazuar.

- të anulohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK-së të datës 16.05.2023, ndërkaq lënda të kthehet në rivlerësim me qëllim të trajtimit të barabartë të OE-ve dhe të kërkohen informata shtesë në pajtim me dispozitat e nenit 72 të LPP-së

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "A-Z Group" sh.p.k.

Sqarim hyrës: AK më datë 06.03.2023 ka publikuar njoftimin për kontratë për AP "Rregullimi dhe zgjerim i parqeve ne Kline" dhe më datë 27.03.2023 është bërë hapja e ofertave. Me datë 16.05.2023 AK ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK. OE ankues më datë 21.05.2023 ka

paraqitur kërkesë për rishqyrtim tek AK, dhe më datë 23.05.2023 AK ka publikuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim si të pabazuar. OE ankues më 01.06.2023 ka paraqitur ankesë pranë OSHP-së.

Pretendimi 1: AK-ja me rastin e zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka bërë shkelje të nenit 1 të LPP-së , sepse konform nenit 1 të LPP-së parashihet : Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla, ndërsa autoriteti kontraktues në rastin konkret nuk iu ka përmbajtur nenit në fjalë, sepse ka shpërblyer me kontratë një operator ekonomik me çmim më të lartë. AK-ja në rastin konkret ka bërë shkelje të nenit 6 të LPP-së(parimin e ekonomicitetit dhe efikasitetit),sepse ka rekomanduar për shpërbllim një operator ekonomik me çmim më të lartë dhe njëkohësisht të papërgjegjshëm.

Përgjigje në pretendimin 1: Lidhur me këtë pretendim ekspertja shqyrtuese sqaron se AK është i obliguar që fondet publike ti përdor në mënyrë të drejtë, transparente dhe në mënyrë ekonomike.

Pretendimi 2: AK-ja me rastin e zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka bërë shkelje të nenit 7(barazia në Trajtim/Mos diskriminimi),duke na eliminuar ne si operator ekonomik ofertues me çmim më të ultë ,kundrejt operatorit ekonomik të rekomanduar për shpërbllim me kontratë, edhe pse i njëjti nuk i plotëson kriteret e dosjes së tenderit, mirëpo favorizohet nga ana e autoritetit kontraktues. Bazuar ne kërkesën për qasje në Dokumentacion e OE Mendi Invest SHPK dhe Idero Construction sh.p.k, dhe pas qasjes në ofertën e tij kem konstatuar si vijon: Grupi i operatorëve ekonomik në fjalë nuk i ka përmbushur kërkesat ne lidhje me konzorciumin, ashtu siç kërkohet sipas ligjeve ne fuqi ku kërkohen 3 deklarata veç e veç për formimin e konsorciumit , por ka paraqitur vetëm një deklaratë mbi themelimin e grupit, dhe asnjë tjetër që dëshmon dhe që i përmbush kërkesat e dosjes së tenderit. · Po ashtu Grupi i operatorëve ekonomik nuk e ka të përcaktuar LIDERIN e grupit siç kërkohet me legjislacionin në fuqi. Grupi i OE në mungesë të përcaktimit të liderit të grupit do duhej të shpallej si i PAPËRGJEGJSHËM, sepse i njëjti nuk i ka plotësuar kushtet e parapara në nenin 71 të LPP-së dhe nenin 26.1 të Rregullores Nr.001/22 Për Prokurimin Publik.

Përgjigje në pretendimin 2: Pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumenteve të prezantuara në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë Mendi Invest SH.P.K & Ideor Construction SH.P.K, ekspertja shqyrtuese sqaron se ky OE ka prezantuar një deklaratë mbi themelimin e grupit e cila i përmban të gjitha të dhënat e kërkuara sipas nenit 26 paragrafi 26.1 të Rregullores nr. 001/2022 për prokurim publik sipas të cilit: Një tender mund të dorëzohet nga një grup i Operatorëve ekonomik. Në këtë rast grupi, me tenderin e tyre, duhet te:

Dorëzon një deklaratë të qartë që të gjithë anëtarët e grupit janë së bashku dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit, dhe në rast se grupit i jepet kontrata, për performancën e kontratës;

Dorëzon një deklaratë të nënshkruar nga secili nga anëtarët, që konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se nuk janë duke marrë pjesë individualisht dhe/ose në grupe tjera në procedurën e njëjtë të prokurimit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm);

Një deklaratë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët të grupit për të autorizuar partnerin udhëheqës të veprave në emër të grupit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm);

Secili anëtar i grupit duhet të jetë i regjistruar në platformën elektronike, kërkesë e cila duhet të përcaktohet në dosje të tenderit. (Nënshkrimi digjital i avancuar nuk është i obligueshëm deri në njoftim zyrtar nga KRPP). Po ashtu forma e përdorur për hartimin e kësaj deklarate është në përputhje me paragrafin 26.2 të Rregullores nr.001/2022 për prokurim publik në të cilin thuhet se: Deklaratat e kërkuara në (a), (b) dhe (c) të paragrafit 26.1, mund të përfshihen në një dokument. Bazuar në këtë sqarim ky pretendim i OE ankues është i pabazuar.

Pretendimi 3: Përshtatshmëria financiare: sipas nenit Nenit 26 pika 26.4 dhe sipas kriterëve të përcaktuar në dosjen e tenderit ku kërkohet: Grupi i operatoreve ekonomik e me konkretisht kompania Mendi INVEST SH.P.K. me nr te biznesit 811983916, i cili fillimisht NUK e ka dorëzuar fare certifikatën e biznesit e as te TVSH-së. Dëshmitë për këtë i kemi paraqitur në kërkesën për rishqyrtim.

Përgjigje në pretendimin 3: Lidhur me këtë pretendim ekspertja shqyrtuese sqaron se në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë nuk janë të bashkangjitura certifikata e regjistrimit të biznesit dhe certifikata e TVSH-së për OE Mendi Invest SH.P.K., edhe pse në përgjigjen e AK për OE A-Z Group SH.P.K e kanë cekur që OE i rekomanduar i ka dërguar këto certifikata pas kërkesës për sqarim nga AK por që të njëjtat nuk figurojnë të ngarkuara në platformën elektronike e-prokurimi. AK gjatë fazës së vlerësimit duhet të vepronte sipas nenit 10 paragrafi 10.1 të Udhëzuesit nr.001/2023 për prokurim publik i cili e sqaron:

Mungon Certifikata e regjistrimit të biznesit	Mund të kërkohen informata sqaruese	Sipas nenit 66 të LPP-së
Mungon Certifikata e TVSH	Mund të kërkohen informata sqaruese	Sipas nenit 66 të LPP-së

Pas shqyrtimit të dokumenteve të ngarkuara në platformën elektronike për këtë AP, ekspertja sqaron se nuk gjeti dëshmi që OE Mendi INVEST SH.P.K ka prezantuar certifikatat për

regjistrim të biznesit dhe TVSH-së, prandaj ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi 4: Grupi i operatorëve ekonomik të rekomanduar për shpërblim me kontratë nuk i ka plotësuar as Kërkesat mbi mundësit teknike dhe-ose profesionale - kapaciteti Teknik dhe profesional · Konkretisht nuk e ka plotësuar pikën 9.1&9.2 të dosjes së tenderit,sepse vlera e kontratave të ofruara arrin shumën prej 20,585.30 euro,e jo 30,000.00 siç është kërkuar në dosjen e tenderit, nëse respektohet kriteri i kërkuar në dosje të tenderit lidhur me punët e ngjashme të realizuara, sepse Grupi i operatorëve ka ofruar kontrata e referenca edhe për punë të pa përfunduara dhe kontrata që nuk përkujnë me aktivitetin e prokurimit në fjalë,siç janë punët e fasadimit dhe molerimit. Në këto pretendime ankimore më gjerësisht i kemi potencuar në kërkesën për rishqyrtim të cilën kërkesë na e ka refuzuar autoriteti kontraktues. Në të dyja rastet shihet qartë se grupi I OE ekonomik të rekomanduar për shpërblim me kontratë nuk përmbush kriteret minimale si për nga Punët e Ngjashme, ashtu edhe nga pjesa e Çarkullimit Financiar.

Përgjigje në pretendimin 4: Bazuar në kërkesën e publikuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe FDT

Kërkesa 4- Operatori Ekonomik duhet te ofroje dëshmi se ka realizuar projekte te ngjashme ne periudhën e 36 muajve te fundit para datës se publikimit te njoftimit për kontrate ne vlerën prej se paku 30.000.00 Euro, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit dhe dëshmi për përfundimin me sukses te këtyre projekteve.	Dëshmia -1 - Te dorëzoni listën në origjinal evulosur nënshkruar, të projekteve të ngjashme tërealizuara ne vitet e shkuara nga data epublikimit te njoftimit për kontrate, dhe dëshmitë epërfundimit Referencat procesverbalet e pranimit teknik.
--	--

si dhe pas analizimit të dokumenteve të prezantuara në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, ekspertja shqyrtuese sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar dëshmi të mjaftueshme që e plotëson këtë kërkesë të autoritetit kontraktues, i njëjti ka prezantuar listën e kontratave për punët e përfunduara shuma e secilës e tejkalon vlerën e kërkuar sipas AK dhe për kontratat që ka ofruar dëshmitë si raport të pranimit teknik po ashtu e tejkalon vlerën prej 30,000€ siç është kërkuar në NJK dhe FDT. Prandaj ky pretendim i OE ankues vlersohet si i pabazuar.

Pretendimi 5: Grupi i operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar pikën 9.1&9.2 kërkesa 5 të dosjes së tenderit, Sipas kërkesës që staf i tjetër profesional min.5, te punësuar të përhershëm apo me kontrata kohore te caktuara, OE ne listën e dërguar te stafit ka përcaktuar · Remzi Cakollin si Fasader - moler · Meriton Berisha si Fasader - moler · Sipas dosjes se tenderit, ku natyra e ngjashme e kontratës i përket Ndërtimit të Ulët e që fasadim dhe molerim nuk ka sipas projektit të dorëzuar nga AK, i bie qe punëtorët e stafit Teknik nuk janë adekuat për kontratën e përcaktuar dhe si e tillë i bie që normalisht lista e stafit Teknik nuk i plotëson kërkesat sipas FTD me min. 5 punëtorë. Dhe si e tille Grupi I OE nuk përmbush pikën 9.1&9.2 kërkesa nr.5 e dosjes së tenderit.

Përgjigje në pretendimin 5: Lidhur me këtë pretendim ekspertja shqyrtuese sqaron se kërkesa e AK lidhur me stafin teknik është: Staf tjetër min 5 , të punësuar te përhershëm apo me kontrata për kohe te caktuar dhe si dëshmi për stafin teknik është kërkuar: për stafin teknik duhet të këtë kontrata apo parakontrat për këtë projekt. Pra sipas kërkesës së AK në njoftim për kontratë dhe në FDT nuk është cekur profesioni që punëtorët e stafit teknik duhet të kenë, janë kërkuar si staf teknik vetëm 5 punëtor pa ndonjë kriter tjetër, prandaj duke u bazuar në këtë kërkesë të AK dhe dokumentet e dorëzuar nga OE i rekomanduar lidhur me stafin teknik, ky OE e ka plotësuar kërkesën e AK dhe pretendimi i OE ankues është i pabazuar.

Pretendimi 6: Grupi I OE të rekomanduar për kontratë ka paraqitur listën e stafit Teknik dhe profesional, ku në listën e dorëzuar ka përcaktuar Durim Shalën si Menaxher të kontratës. Durim Shala nuk përmbush kërkesat e pikës 9.1&9.2 kërkesa nr.5 dëshmia dokumentare nr.2 e Dosjes se tenderit ku kërkohet që - OE duhet të ketë një INXHINER të emëruar me vendim Menaxher te kontratës se paku 2 vite përvojë pune, dhe sipas dëshmisë se kërkuar dokumentare I njëjti duhet te prezantoj CV, Diplomën e noterizuar si dhe referencat për punët e kryera (për të cilat personi në fjalë nuk i posedon fare). Fillimisht Durim Shala nuk ka ndonjë përgatitje profesionale inxhinerike siç kërkohet sipas kërkesës se FTD, por është paraqitur si punëtor menaxher sipas kontratës së rregullt të dorëzuar për këtë person. Lista e ofruar nga OE ka mospërputhje me dokumentet përcjellëse te stafit, pra sipas Listës MENAXHER është Durim Shala, ndërsa në VENDIMIN PER MENAXHER e ka deklaruar Jasmir Morina. Pra Grupi i operatoreve ekonomik në fjalë nuk e ka përmbushur pikën 9.1&9.2.kërkesa nr.5 e dosjes së tenderit.(edhe ky pretendim ankimor është parashtruar së bashku me kërkesën tonë për rishqyrtim me prova dhe fakte si dhe me listën e punëtorëve por nuk është marr parasysht nga ana e autoritetit kontraktues).

Përgjigje në pretendimin 6: Sa i përket këtij pretendimi ekspertja shqyrtuese sqaron se OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka prezantuar një listë për stafin profesional dhe teknik në të cilën Z.Durim Shala e ka paraqitur në pozitën në kompani si Agjent- Menaxher dhe i njëjti figuron edhe tek certifikatat e regjistrimit të biznesit te kompanisë tek lista e pronarëve dhe personave te autorizuar, ndërsa lidhur me kërkesën e AK që OE duhet të prezantoj një inxhinier të diplomuar i cili me vendim duhet emëruar edhe menaxher i projektit, OE i rekomanduar për kontratë lidhur me këtë kërkesë ka prezantuar Ing. Jasmir Morina për te cilin ka prezantuar, diplomën e noterizuar, kontratën e punës, CV si dhe vendimin për caktimin e menaxherit të projektit sipas kërkesës së AK. Ky pretendim i OE ankues është i pabazuar.

Pretendimi 7: Grupi i operatoreve ekonomik në fjalë nuk e ka përmbushur as pikën 9.1&9.2.kërkesa nr.6 e dosjes së tenderit,sepse sipas marrëveshjes për qiramarrje ndërmjet Arifaj shpk (nga Shqipëria) dhe kompanisë IDEO CONSTRUCTION, kanë dërguar një foto për një kamion me kran I cili nuk posedon librezën valide të regjistrimit të mjetit me të dhënat specifike për mjetin dhe si të tillë nuk përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë teknike. 1. Kapaciteti teknike dhe profesional -se OE duhet të ketë ndër të tjera: min.1 kamion me kapacitet 10m3 .Pajisjet Sipas marrëveshjes për qiramarrje ndërmjet NNP VETONI shpk dhe kompanisë IDEOR CONSTRUCTION, është paraqitur lista e mjeteve me të dhënat specifike për pajisjet e marra me

qera dhe si te tilla shihet qe dy kamionët e vendosur ne liste posedojnë librezën e qarkullimit por qe te dyja mjetet i kane TE SKADUARA afatet e qarkullimit qe nga viti 2021. Bazuar ne kriteret e përcaktuara dhe sipas ligjeve ne fuqi, Grupi I OE nuk përmbush kërkesat minimale të përcaktuara nga AK sipas FTD.

Përgjigje në pretendimin 7: Lidhur më këtë pretendim që kërkesa e AK është: Një kamion min 10m3 - Dëshmia 3- Dëshmi mbi posedimin e pajisje, nëse pajisjet janë në pronësi të OE duhet të ofroj (Librezat kopje ose Dokumentin Unik Duganor, faturat e blerjes). Nëse OE ka Marrëveshjet për Shfrytëzim të pajisjeve OE duhet të ofroj Marrëveshjen (për Projekt) për shfrytëzim të pajisjeve dhe dëshminë mbi pajisjet e marruara me qera si (kopjen e librezave ose Dokumentin Unik Duganor) Dëshmia - OE duhet ti dëshmoj marrëveshjet me prodhuesit dhe pas analizimit të dokumenteve te prezantuar ne ofertë nga OE i rekomanduar për kontratë ekspertja shqyrtuese sqaron se OE Ideor Construction ka prezantuar dy kontrata për marrjen me qera të mjeteve, një kontratë me kompaninë "Arifaj SH.P.K" dhe kontrata tjetër me kompaninë "NNP VETONI" me anë të të cilave përveç mjeteve të tjera ka marrë në shfrytëzim edhe kamion nga të dy kompanitë. Kamioni me targat TR 0397 K i marr në shfrytëzim nga kompania "ARIFAJ SH.P.K" posedon certifikatë të kontrollit teknik dhe policë të sigurimit por Leja e qarkullimit për këtë mjete është me afat të skaduar, po ashtu edhe për kamionët me targa 07-713-DS dhe 07-162-DL të cilët OE i rekomanduar për kontratë i ka marr në shfrytëzim nga kompania "NNP VETONI", librezat e qarkullimit janë me afat të skaduar. Duke u bazuar në Nenin 39 paragrafi 1 i ligjit nr.05/L-132 për automjetet i cili thotë: Në mënyrë që të marrin pjesë në trafik rrugor, mjetet duhet të jenë të regjistruara dhe të posedojnë certifikatë të regjistrimit të mjetit valide ose leje valide për ngasje provuese, të jetë i shënuar me targë regjistrimi ose targa provuese të vendosura për identifikim të mjetit. Prandaj bazuar në këtë sqarim ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi 8: Grupi I OE nuk përmbush kërkesat minimale të FDT dhe atë pikën 5.2 lidhur me PLANIN dinamik prej 60 ditëve.AK-ja në dosje ka kërkuar plan dinamik, kurse Grupi i operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë nuk ka hartuar fare Planin dinamik, por vetëm një tabelë me 1 rresht, duke shkruar qe afati i realizimit të projektit është 60 ditë. Është absurditet i AK-së ta emërtojë dhe ta pranojë atë pamflet si plan dinamik ,kur fare mirë dihet se çfarë duhet të përmbajë plani dinamik.

Përgjigje në pretendimin 8: Lidhur me këtë pretendim OE i rekomanduar për kontratë ka paraqitur një dokument i cili mban emrin Plani dinamik për realizimin e projektit dhe afatin 60 ditë, ekspertja shqyrtuese sqaron se plani dinamik paraqet planifikimin dhe strukturimin e aktivitetit punues në varësi të kohës, mirëpo AK në kërkesën e tij në FDT nuk ka cekur nëse kërkon plan dinamik detal vetëm ka kërkuar plani dinamik në afat 60ditë, prandaj mbetet përgjegjësi e AK nëse një plan dinamik siç e ka prezantuar OE i rekomanduar për kontratë i plotëson kërkesat e AK apo jo.

Pretendimi 9: Grupi i operatorëve ekonomik si më sipër ka bërë shkelje të pikës 13.1 të dosjes së tenderit ,përkritazi me sigurimin e tenderit,sepse Siguria e tenderit e Dorëzuar nga OE tregon qe

është dorëzuar vetëm në emër të OE MENDI INVEST SH.P.K., dhe nuk është bërë sigurimi në emër të grupit të operatoreve, e që realisht i bie që për siguri të tenderit nuk merr përgjegjësi kompania tjetër e konzerciumi. Nga sa u tha më sipër shihet qartë se AK-ja ka bërë diskriminim ndaj nesh si ofertues ndërsa ka favorizuar hapur një ofertues i cili ka qenë totalisht i pa përgjegjshëm.

Përgjigje në pretendimin 9: Sa i përket këtij pretendimi ekspertja shqyrtues sqaron se nuk ka ndonjë bazë ligjore e cila i obligon OE që sigurimin e tenderit ta bëjë në emër të grupit të operatoreve ekonomik, në rastin konkret sigurimi i tenderit është bërë në emër të OE "Mendi Invest" Sh.P.K i cili edhe në deklaratën mbi themelimin e grupit është i caktuar si lider i grupit për këtë aktivitet të prokurimit. Prandaj ky pretendim është i pabazuar.

Pretendimi 10: AK-ja me rastin e rekomandimit të Grupit të operatorëve ekonomik për kontratë lidhur me tenderin si më sipër, ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së, sepse me rastin e vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit të tenderëve ka rekomanduar për shpërblim një operatorë ekonomik të papërgjegjshëm dhe me çmim të ofertës financiar e më të lartë siç dëshmuam me prova si më sipër, ndërsa na ka eliminuar neve nga gara e mëtutjeshme në këtë aktivitet të prokurimit pa arsye ligjore. · AK-ja me rastin e zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka bërë shkelje të nenit 60 par.1.pika 1.1 të LPP-së, sepse nuk ka respektuar kriteret e dhënies së kontratës e që në rastin konkret ishte çmimi më i ulët, me që rast AK-ja e rekomandon për shpërblim me kontratë një operator ekonomik me çmim më të lartë dhe njëkohësisht të pa përgjegjshëm.

Përgjigje në pretendimin 10: Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK është i obliguar që të veproj në pajtim të plotë me LPP-në dhe legjislacionin sekondar për prokurim publik që nga inicimi i një aktiviteti të prokurimit deri në përfundimin e tij.

Pretendimi 11: AK-ja gjatë udhëheqjes së këtij aktiviteti të prokurimit ka bërë shkelje të nenit 72 të LPP-së, sepse edhe përkundër faktit se nga ne ka kërkuar sqarime shtesë më dt.04.04.2023, ne menjëherë ia kemi dërguar dokumentet siç janë : Marrëveshjet(2) për qiramarrje të mekanizmit së bashku me dokumentacionet përcjellëse si dhe dokumentacionin e makinës ngjeshëse e cila është pronë e kompanisë, ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit. Pra arsyeja e AK-së se gjoja nuk keni paraqitur listën e pajisjeve me asnjë numër identifikues është e habitshme sepse askund në dosje të tenderit nuk është kërkuar numri identifikues siç pretendon AK-ja. Potencojë se edhe përkundër sqarimeve të dhëna nga ana e jonë, AK-ja prapë nuk i merr për bazë sqarimet tona. Ndërsa sa i përket pretendimit të AK-së se marrëveshjet për qiramarrje nuk kanë qenë në ofertë ky pretendim është i vërtetë, por ne këto marrëveshje i kemi dërguar pas kërkesës për sqarim nga ana e AK-së konform nenit 72 të LPP-së. Kurse sa i përket listës së pajisjeve ne deklarojmë se e njëjta është ngarkuar qysh me rastin e dorëzimit të ofertës, kurse specifikimet për numra identifikues nuk janë kërkuar askund në dosje të tenderit.

Përgjigje në pretendimin 11: Lidhur me këtë pretendim gjatë fazës së vlerësimit të tenderëve AK ka dërguar Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit tek OE A-Z Group Sh.P.K me anë të secilës ka kërkuar që OE të dorëzoj dëshmi për pajisjet për të cilat me rastin e ofertim OE ka ngarkuar vetëm listën e pajisjeve. OE ankues me rastin e dorëzimit të dëshmimeve lidhur me

pajisjet ka prezantuar edhe marrëveshje për qiramarrje të pajisjeve pasi pajisjet e prezantuara nuk janë në pronësi të OE ankues dhe për këtë arsye duhet të prezantojnë marrëveshje me palë tjera për shfrytëzim të mjeteve. Ekspertja shqyrtuese sqaron se duke marr parasysh kërkesën për sqarim të tenderit nga AK për OE ankues si dhe duke u bazuar në nenin 72 të LPP-së, pretendimi i OE ankues është i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Konstatimet e Panelit Shqyrtues -

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrirat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe si rrjedhojë paneli vendosi që ankesa OE "A-Z Group" sh.p.k., të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 16.05.2023 për aktivitetin e prokurimit të lartë cekur dhe lënda të kthehet në rivlerësim. PSH i mbështet përgjigjet e dhëna në raportin e ekspertizës përveç pretendimit nr. 7 të cilin nuk e mbështet dhe pretendimet që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit të OE ankues.

Sipas Dojes së Tenderit kërkesa ka qenë që "**Dëshmia 3- Dëshmi mbi posedimin e paisje, nëse paisjet janë në pronësi të OE duhet të ofroj (Librezat kopje ose Dokumentin Unik Duganor, faturat e blerjes). Nëse OE ka Marrëveshjet për Shfrytëzim të paisjeve OE duhet të ofroj Marrëveshjen (për Projekt) për shfrytëzimin të paisjeve dhe dëshmin mbi paisjet e marrura me qera si (kopjen e librezave ose Dokumentin Unik Duganor) Dëshmia - OE duhet të dëshmojë marrëveshjet me prodhuesit.**". Me çrast në ofertën e OE ankues, nuk ka pasur marrëveshje për paisjet të cilat janë marrur me qira, fakt të cilin e konfirmon edhe vetë OE ankues, por pas sqarime të kërkuara nga AK, OE ankues ka sjell këto marrëveshjet të cilat nuk dëshmojnë se kanë ekzistuar para skadimit të afatit për dorëzim të tenderëve, ashtu siç e kërkon nenin 72 i LPP, andaj PSH vendosi se arsyet e eliminimit të OE ankues në letër standarde të eliminimit nga ana e AK, janë të qëndrueshme.

Shkaku kryesor i kthimit të aktivitetit të prokurimit në fazën e ri-vlerësimit është përshkak të pretendimeve nr. 3, për të cilin duhet të kërkohen sqarime shtesë konform nenit 72 të LPP dhe pretendimit nr. 7 i cekur në raportin e ekspertizës lidhur me skadimin e lejeve të qarkullimit të kamionëve të cilët janë marrur me marrëveshjen me qira, PSH vendosi që për këto dokumente të vihet në funksion nenin 72 i LPP, sepse janë dokumente të cilat mund të verifikohen në mënyrë objektive se a ju është vazhduar validiteti me kohe, andaj, të kërkohen sqarime konform këtij neni "*Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji. Sigurimi i*

informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive." PSh lidhur me këtë pretendim vendosi edhe në konsistencë të vendimeve të saja.

Dispozitivi për pikën 1 dhe 3 është marrur për shkak se ankesa ka bërë që lënda të kthehet në rivlerësim, ndërsa OE ankues nuk ka arritur të dëshmoj se për këtë aktivitet të prokurimit është i përgjegjshëm.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**
- **OE - " A- Z Group " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: